



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 10, paragrafi 1.5 i Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 20, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 të Rregullores QRK, nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës dhe të nenit 34 paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2016, miratoi këtë

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM
KOMPANISË KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI
ELEKTRIKE (KEDS)

- I. Miratohet Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, në shfrytëzim jepet pjesa e parcelës kadastrale nr. 307 – 0, me sipërfaqe 24 m², Zona kadastrale Prishtinë.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekura në pikën II të këtij propozimi, është vendosja e trafostacionit elektro-energjetik TSB – 400 KVA.
- IV. Prona e paluajtshme e Komunës e cekur në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim për periudhën afatshkurtër, për 15 vite.
- V. Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij propozimi, jepet në shfrytëzim me kompensim. Shuma vjetore që do të paguaj Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) për shfrytëzimin e pronës është 1728 euro.
- VI. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të autorizuar të shfrytëzuesit të pronës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe organi kompetent për regjistrimin e pronës së paluajtshme të Komunës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.nr. 463-133255 ,më 31.05.2016

